



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2020

PËR

RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ANGAZHIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE, DHE ALEANCËS GAVI,
PËR PJESËMARRJEN NË STRUKTURËN GLOBALE TË QASJES
NË VAKSINAT COVID-19 (COVAX FACILITY)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 2 dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (*Covax Facility*), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI